

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime prioritare

Nr.	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
3	Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje reale për të rritur ndërgjegjësimin për fenomenin e hershëm të blerjes së votës dhe rreziqet që sjell ajo për integritetin e zgjedhjeve. Denoncimi publik i praktikave të tilla para dhe gjatë fushatës nga aktorët kryesorë, duke përfshirë zyrtarët shtetërorë dhe drejtuesit e partive, mund të shërbejë për frenimin e këtij fenomeni.	Progres i Moderuar	Zbatimi i këtij rekomandimi nuk kërkon të bëhen ndryshime në legjislacion. Për të zvogëluar këtë fenomen është e nevojshme angazhimi i KQZ dhe shoqërisë civile. KQZ ka organizuar dhe zhvillon aktivitete që synojnë rritjen e ndërgjegjësimin të zgjedhësve për qëndrim dhe reagim ndaj fenomenit të shitblerjes së votës. Shoqëria civile është e angazhuar në denoncimin e fenomeneve të shitblerjes së votës, edukimin e zgjedhësve dhe nxitjen e institucioneve ligjzbatuese për dënimin e personave që konsumojnë veprën penale të shitblerjes së votës. Reagimi i institucioneve ligjzbatuese ndaj këtij fenomeni nuk ka arritur t`i përgjigjet intensitetit të shtuar të tij. Perceptimet për punën dhe efektin e këtyre institucioneve si instrumenta thelbësor në luftën kundër këtij fenomeni është larg pritshmërive.